

Projekti QUADIC - UKZ - Koordinator

UKZ është Koordinator i një projekti në Erasmus +, me 18 partnerë vendor dhe ndërkombëtar, me buxhet prej 991,831.00 €. Projekti ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve për ndërkombëtarizim dhe shkrimin e menaxhimit të projekteve dhe do të zgjasë deri në vitin 2023. Projekti QUADIC ka të bëjë me ndërkombëtarizimin dhe ngritjen e kapaciteteve në shkrim dhe menaxhim të projekteve dhe përfshinë gjithsejt 10 paketa punuese. Në kuadër të këtij projekti parashihet të krijohen zyrat për bashkëpunim ndërkombëtar dhe projekte nëpër ato universitete që ende nuk i kanë krijuar dhe të forcohen zyrat ekzistuese të universiteteve partnere që tashmë i kanë këto zyra. Gjithashtu, është krijuar edhe dokumenti kryesor, pra Strategjia për Ndërkombëtarizim, me të cilin do të caktohen prioritetet dhe mënyra e funksionimit të universiteteve kundrejt ndërkombëtarizimit dhe globalizimit. Poashtu në kuadër të projektit është edhe në proces krijimi i platformës digjitale për menaxhimin e marrëveshjeve dhe projekteve ndërkombëtare nga ana e partnerëve të konzorciumit dhe e cila do të mund të zgjerohet në të ardhmen me përfshirjen edhe të universiteteve dhe organizatave tjera që dëshirojnë të antarësohen. Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është të përmirësojë cilësinë në IAL-të në Kosovë dhe në Shqipëri; ndërtimi i kapaciteteve institucionale për marrëdhëniet ndërkombëtare; krijimi ose bërja e zyrave përkatëse plotësisht funksionale (përfshirë kapacitetin për menaxhimin e ciklit të projektit) në anëtarët e konsorciumit.